



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 09-60/01-25460/22
Kaçanik, 29.09.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 (d) lidhur me nenin 17 pika (r) dhe (s) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 12.2 dhe 12.5 dhe 13 të Ligjit Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës, të Shkresës së Muzeut Kombëtar të Kosovës 01/268 të datës 27.09.2022, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës së Kaçanikut nëpërmjet Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport 01Nr. 09-60/01-25460/22, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 Shtator 2022, mori këtë:

VENDIM PËR THEMELIMIN E MUZEUT TË QYTETIT TË KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, Themelohet Muzeu i Qytetit të Kaçanikut.
2. Muzeu i Qytetit të Kaçanikut do të jetë institucion kulturor lokal që do të bëjë arkivimin, selektimin, ruajtjen dhe promovimin e relikteve, dokumenteve dhe gjësendeve tjera të trashëgimisë së luajtshme me peshë historike individuale dhe shoqërore nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe periudhave tjera historike.
3. Qëllimi i themelimit të Muzeut të Qytetit është grumbullimi, selektimi dhe ruajtja e dokumenteve dhe relikteve me peshë historike të dhuruara për institucionin, me qëllim të promovimit të tyre para publikut.
4. Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut do të përcaktohen me Statutin dhe aktet tjera normative të këtij institucioni.
5. Muzeu në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë, detyrave dhe kompetencave të tij do të organizojë njësitë përkatëse organizative me punonjës të kualifikuar të cilët do të përgatisin statutin dhe aktet tjera normative të cilat do të dërgohen për miratim në Kuvendin e Komunës.
6. Muzeu i qytetit përkohësisht do të vendoset në ambientet e Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” në Kaçanik.
7. Pjesë përbërëse e Vendimit janë: Shkresa e Muzeut Kombëtar të Kosovës 01/268: Propozim Vendimi 01Nr.09-60/01-25460/22; Shkresa e Organizatave të dala nga Lufta e UÇK-së e 16.09.2022; Kërkesa e Këshillit të Iniciativës qytetare 01Nr. 104/02-25411/22.

8. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe organet tjera relevante.


9. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:


1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante);
3. Drejtorja e Buxhetit dhe Financave;
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Data	10.10.2022	Vendi	KAÇANIK
Nr. org.		Numri	
	01	60/01-27164	-1

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut. Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut.
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MAPL-së. Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL-së.
Përmes:	Hajrulla Çeku, Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Bislim Bislimi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Nga:	Feim Hoxha, Drejtor i Departamentit Ligjor në MKRS-së. Datë: 10.10.2022
Zyrtarët përgjegjës:	Mehdi Uka, Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrje dhe Zbatim të legjislacionit në MKRS-së. 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Labinot Binakaj, Zyrtari hartues i vlerësimit.
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	☐ Statut i komunës ☐ Rregullore ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ ☐ Akt tjetër i komunës:

I nderuar Kryetar/e,

I nderuar Kryesues/e,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet baze dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

☐ Emri i aktit (vendim, rregullore, statut) Vendimi 01Nr. 09-60/01-25460/22, për themelimin e Muzeut të qytetit të Kaçanikut.
I miratuar më datë: 29.09.2022
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.10.2022
I dërguar për shqyrtim në MKRS-së më datë: 07.10.2022

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi nga fushëveprimtaria e MKRS-së.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



№ 01/268 dt. 27.09.2022



MUZEU KOMBËTAR I KOSOVËS
NACIONALNI MUZEJ KOSOVA
NATIONAL MUSEUM OF KOSOVA

SHKRESË PËRCJELLËSE

Në bazë të kërkesës së datës 26.09.2022, me nr. 104/02-25734/22 nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Komuna Kaçanik, duke u bazuar në rekomandimin e Sektorit të Historisë,

Muzeun Kombëtar të Kosovës e inkurajon dhe e mbështet plotësisht iniciativën e komunës së Kaçanikut për themelimin e Muzeut Komunal të Kaçanikut.

Me këtë rast, duhet të potencohet se, Muzeu Kombëtar i Kosovës si institucion qendror, që përfaqëson fushën e muzeologjisë në Kosovë, është i thirrur që të japë ide, këshilla dhe rekomandime profesionale të kësaj natyre, por ky rekomandim nuk përmban ndonjë efekt juridik, në mungesë të legjislacionit aktual.

Në këtë drejtim do t'ju perkrahim me gjithë stafin profesional që ka në dispozicion ky institucion.

Me respekt,

Ajet LECI




Prishtinë, 27.09.2022

Drejtor në Muzeun Kombëtar të Kosovës



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republi of Kosova



Komuna e Kaçanikut
Opstina Kacanik
Municipality of Kacanik

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Nr. 66/01-25460/22

Datë: 19.09.2022

Në mbështetje të Nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, nenit 17 pika r dhe s të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008), Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 dhe 12.5 të Ligjit Nr 02/L-57 për Institucionet e Kulturës, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i propozon Kuvendit të Komunës së Kaçanikut këtë :

PROPOZIM – VENDIM

PËR THEMELIMIN E MUZEUT TË QYTETIT TË KAÇANIKUT

I

Muzeu i Qytetit të Kaçanikut do të jetë institucion kulturor lokal që do të bëjë arkivimin, selektimin, ruajtjen dhe promovimin e relikteve, dokumenteve dhe gjëseneve tjera të trashëgimisë së luajtshme me peshë historike individuale dhe shoqërore nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe periudhave tjera historike .

II

Qëllimi i themelimit të Muzeut të Qytetit është grumbullimi, selektimi dhe ruajtja e dokumenteve dhe relikteve me peshë historike të dhuruara për institucionin, me qëllim të promovimit të tyre para publikut.

III

Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut do të përcaktohen me Statutin dhe aktet tjera normative të këtij institucioni.

IV

Muzeu në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë, detyrave dhe kompetencave të tijë do të organizojë njësitë përkatëse organizative me punonjës të kualifikuar të cilët do të përgatisin statutin dhe aktet tjera normative të cilat do të dërgohen për miratim në Kuvendin e Komunës.

V

Muzeu i qytetit përkohësisht do të vendoset në ambientet e Shtëpisë së Kulturës “ Xheladin Kurtaj “ në Kaçanik .

Kryetari Besim Ilazi



ARSYETIM

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit pas kërkesave të shoqatave të dalura nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kërkesës së përsëritur të Këshillit Themelues të Iniciativës Qytetare për Themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut, dhe pas kontakteve të vazhdueshme me drejtues të Muzeut Kombëtar të Kosovës dhe mbështetjes së ofruar nga ata, vendosi që ti drejtohet Kuvendit të Komunës me këtë propozim-vendim për themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.

Ky institucion me rëndësi të madhe Kulturore dhe Historike do të jetë i pari i këtij lloji në komunën tonë i cili do të bëjë arkivimin, selektimin, ruajtjen dhe promovimin e relikteve, dokumenteve dhe gjësendeve të tjera të trashëgimisë me peshë Historike dhe Kulturore.

Komuna e Kaçanikut ka një trashëgimi të pasur kulturore dhe historike në periudha të ndryshme të historisë duke filluar nga kohrat antike, luftërat ndaj pushtuesve ottoman në Grykën e Kaçanikut e deri te Shpallja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës e njohur si Kushtetuta e Kaçanikut dhe Lufta e Lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në të cilën luftë ranë shumë heronjë, dëshmorë dhe martirë.

E gjithë kjo na bën të vetëdijshëm se themelimi i Muzeut të Qytetit të Kaçanikut është nevojë e domosdoshme me qëllim të ruajtjes dhe promovimit të kësaj trashëgimie të pasur Kulturore dhe Historike në Komunën tonë.

Drejtoresha e DKRS

Hafize Sallahi





ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

KAÇANIK

KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSITINA KAÇANIK

Data	16.09.22	Vendi	KAÇANIK
Nr. orig.		Numbri	
	01		104/02 - 27419

PËR: KRYETARIN E KOMUNËS DHE DREJTORIN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT-KAÇANIK.

NGA: SHOQATAT E DALURA NGA LUFTA E UÇK-së - KAÇANIK

LËNDA: KËRKESË PËR THEMELIMIN E MUZEUT TË QYTETIT TË KAÇANIKUT.

Të nderuar,

Me anë të kësaj kërkesë, tri shoqatat e dalura nga Lufta e UÇK-së, kërkojnë nga organi e lartëcekura, të marrin vendim për themelimin e Muzeut të qytetit i cili do të bëjë ruajtjen, promovimin e relikteve, dokumenteve si dhe gjëseneve të tjera të trashigimisë me pesaë historike nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Me respekt.

Organizata e veteranëve të luftës të UÇK-së
Organization of War Veterans of the KLA

Data: Nr. 27

Data: 16.09.2022

Data në Kaçanik



OVL e UÇK-së

Kryetari:

SHIL e UÇK-së

Kryetari:

SHPD e UÇK-së

Kryetari:



Data	16.09.22	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	104/02-38406
		Shtojcë	1

Datë: 15.09.2022

Për: Zyra e Kryetarit të Kuvendit Komunal të Kaçanikut,

Kopje: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Kuvendi Komunal i Kaçanikut,

Kopje: Asambleistët e Kuvendit Komunal të Kaçanikut

Nga: Këshilli i Iniciativës Qytetare për themelimin e muzeut të qytetit në përbërje nga;
Hajredin Ramajli, Irfan Beqa, Ylber Shehu, Fadil Beqa, Driton Ramajli, Sevdije Shehu, Hilmi Hoxha, Afide Kuka, Ramadan Dema, Gjentile Bajra, Jehona Guri, Ermira Krasniqi

Lënda: Azhurnimi i Kërkesës me nr. të protokollit 104/02-38406 dt. 23.12.2021 për themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut

Të nderuar/a

Këshilli i Iniciativës Qytetare për themelimin e muzeut të qytetit në përbërje nga të lartcekurat/it vitin e kaluar ka parashtruar kërkesë për themelimin e muzeut të qytetit cila ishte protokolluar me nr. 104/02-38406. Kjo kërkesë ishte publikuar në rrjetet sociale dhe ishte mirëpritur nga pjesa dërmuese e qytetareve pa dallim moshe apo gjinie. Me kalimin e kohës, qytetarët vazhdimisht i kanë bërë pyetje anëtarëve të këshillit për ecurinë e kërkesës në fjalë, me çka është vërejtur dëshira e tyre për një muze që do të vizitohet nga të gjithë.

Këshilli i Iniciativës Qytetare për themelimin e muzeut të qytetit ka qenë aktiv gjat gjithë kohës duke mbajtur takime periodike të Këshillit si dhe duke mbajtur takim me Kryetarin e Komunës së Kaçanikut dhe Drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit. Përkundër këtyre veprimeve dhe takimeve, deri më tani nuk është vërejtur ndonjë lëvizje pozitive në lidhje me kërkesën e datës 23.12.2021.

Përmes kësaj kërkeje, edhe një herë i bëhet thirrje titujve të adresuar që sa më shpejt që është e mundur ta trajtojnë këtë kërkesë për arsye të mbrojtjes institucionale dhe profesionale të mbetjeve materiale të trashëgimisë kulturore të cilat vazhdimisht i nënshtrohen dëmtimeve të ndryshme.

Duke marr parasysh se çka u tha më lart, si dhe duke pasur parasysh trashëgimin kulturore materiale të Kaçanikut me rrethinë siç janë, gjetjet arkeologjike në formë të monumenteve përkushtimore në arat votive, të hyjnive dhe hyjneshave Ilire, Romake e në veçanti Dardane, kështjellat, monumentet epigrafiqe antike, kapaku i sarkofagut etj të cilët flasin për një të kaluar të bujshme që është zhvilluar në këtë trevë në kohën antike, në anën tjetër duke pasur parasysh se historia mesjetës me monumentet ekzistuese siç është xhamia e qytetit, e me pas fotografitë historike të luftëtarëve të luftës së famshme në grykën e Kaçanikut cilat gjenden në koleksione private, si dhe salla e mbajtjes së mbledhjes historike ku është aprovuar Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e deri në kohën e luftës së fundit për çlirimin e Kosovës, si dhe, interesimi i madh i qytetareve për muze, lindi ideja që të ndërmerret iniciativa qytetare

duke formuar Këshillin Themelues të Iniciativës Qytetare për themelimin e muzeut të qytetit të Kaçanikut e të cilën iniciativë e kanë përkrahur edhe shumë qytetarë/e.

Është botërisht e ditur se trashëgimia kulturore është diçka shumë e çmuar e sidomos kur vlerat e kësaj trashëgimie shprehen përmes mbetjeve materiale me çka identifikohet edhe identiteti i trevës përkatëse.

Mbetje materiale antike arkeologjike të përmendura më lartë janë të vendosura brenda dhe rreth shtëpisë së kulturës në Kaçanik pa ndonjë mbrojtje të veçantë profesionale dhe institucionale. Me themelimin e muzeut të qytetit si e mire e përgjithshme, do të përmblihdeshin në mënyrë të sistemuar të gjitha këto eksponate materiale arkeologjike kurse reparti i etnologjisë do të përmblihdhte të gjitha eksponatet e kulturës materiale dhe shpirtërore të Kaçanikut me rrethinë të cilët janë të pa ekspozuara e që gjenden në koleksione private të cilët duhet konsideruar si donatorë potencial për dhurimin e këtyre eksponateve për ruajtje dhe trajtim profesional.

Gjithashtu, Muzeu i Kosovës do të na pajiste me artefakte të periudhave të ndryshme historike pasi që shumë prej tyre qëndrojnë në depo të pa ekspozuara për arsye të mungesës së hapësirës për ekspozim.

Sa për orientim, lokacioni ku mundet me u hap muzeu i qytetit është shtëpia e kulturës përkatësisht hapësira në katin përdhes nën sallën e leximit të bibliotekës. Për këshillin e lartcekur çdo lokacion tjetër i mundshëm është i mirëseardhur.

Duhet të theksohet se të pakët janë qytetet në Kosovë që nuk kanë muze të qytetit.

Nëse aprovohet kërkesa e Iniciativës Qytetare për themelimin e muzeumit të lartcekur, përveç se në njërën anë do të ishte një atraksion për komunën tonë, në anën tjetër do të bëhej e mundur ruajtja dhe njëkohësisht ekspozimi i trashëgimisë kulturore materiale e trevës së Kaçanikut ku njëkohësisht, qytetarët e kësaj komune do të mundë të informoheshin dhe të kenë dijeni për historinë e kësaj treve, kurse, përfitime më të m' dhaja do të kishte rinia e sidomos nxënësit e shkollave ku me vizitat periodike të organizuar nga organet përkatëse do të informoheshin për historinë e rrethit ku jetojnë duke u bazuar në mbetjet materiale të së kaluarës.

Nga se u tha më lart, Këshilli i Iniciativës Qytetare për themelimin e muzeut të qytetit lutet dhe kërkon nga Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Asambleistët e Kuvendit të K.K. Kaçanik, Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit K.K. Kaçanik që të aprovohet kërkesa për themelimin e Muzeut të Qytetit të Kaçanikut.

Me nderime,

Në emër të Këshillit të Iniciativës Qytetare
për themelimin e muzeut të qytetit të Kaçanikut



Hajredin Ramajli